



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Printjens/Prodato Received/Delivry	08.08.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHAPKIMU	4594/2022		1/1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.775/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2602/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 27.06.2022, ka shqyrtuar ankesën e datës 27.08.2021 me numër A.nr.775/2021 të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar nga Avokat

ne adresë: kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundo Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.775/2021 të datës 27.08.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, me datë 27.08.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me kërkesën e ankuesit për informim për procedurat e llogaritjes së kompensimit material në emër të pagave të papaguara sipas obligime ligjore të përcaktuara në Vendimin A.nr.828/2018 të datës 02.04.2021 të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, ndërsa me datë 01.08.2022 ankuesi ka bërë precizimin e ankesës me pretendimet ankimore për pagesën e kamatës ligjore prej 8% në emër të pagës mujore duke e llogaritur edhe shumën e ngritjes së pagave ndër vite për nëpunësit civil, kompensimin e shumës prej 200€uro në

muaj në emër të rrezikshmërisë, ndërsa në emër të përvojës së punës pagesën e shtesës prej 0.5%, të gjitha këto për periudhën kohore nga data 22.09.2011 deri me datë 21.04.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.08.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administrata Tatimore të Kosovës. Më datë 08.09.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 12.10.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 27.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2602/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 12.10.2021 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 27.08.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe vendosjes në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4424/2021 të datës 27.08.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 22.07.2021; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Përgjigjen e Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të ATK-së të datës 20.08.2021; Vendimin e Këshillit me numër A.nr.828/2018 i datës 02.04.2021; Vendimin e Zv-Drejtorit të ATK-së i datës 21.04.2021 për zbatimin e Vendimit të Këshillit A.nr.828/2021; E-mailin e datës 26.07.2021 dërguar nga ankuesi për përfaqësuesin e tij ligjor avokat me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 21.04.2021 dërguar nga e Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të ATK-së për ankuesin; E-mailin e datës 26.07.2021 dërguar nga ankuesi për përfaqësuesin e tij ligjor avokat me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 13.07.2021 dërguar nga për ankuesin; Tabela e llogaritjes së pagesave dhe interesit mujor për ankuesin nga viti 2011 deri në vitin 2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.08.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 08.09.2021; Kërkesën për pagesë retroaktive të datës 10.06.2021; Listën e pagave të ankuesit për muajin qershor 2021; E-mailin e datës 13.07.2021 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 13.01.2021 dërguar nga për ankuesin; Udhëzim Administrativ Nr.02/20211 me numër protokolli:472; Njoftimin e datës 12.10.2021; Aktgjykimit A.nr.2602/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 27.06.2022; Fletë kthesën e datës 15.04.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se ka përfunduar procedimi administrativ i cili është iniciuar me ankesën e ankuesit

*sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, bazuar në nenin 101 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që përcaktohet se: *“Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë një pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”*, që në rastin konkret procedura administrative e nisur kundër Vendimi me Nr. 01/2016 të datës 24.03.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Vendimi me Nr. 04/2016 i datës 04.09.2015 i Komisionit Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, për çështjen juridike ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, ka përfunduar me rastin e nxjerrjes së Vendimit A.nr.828/2018 të datës 02.04.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila çështje është përfunduar me zbatimin e Vendimit të Këshillit në plotni, sipas Vendimit të datës 23.02.2021 të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, e që në fakt Vendimi i Këshillit me numër A.nr.828/2018 i datës 02.04.2021, ka qenë i qartë ku në pikën III të dispozitivit ka përcaktuar edhe kompensimin material për ankuesin, ndërsa sipas dëshmive të ofruara nga institucioni punëdhënës përmes përgjigjes në ankesë të datës 08.09.2021 është konstatuar se në bazë të listës së pagave për muajin qershor 2021 ankuesi është kompensuar në shumën prej 51,630.92 Euro/Bruto, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vlerëson se ka përfunduar procedimi administrativ i iniciuar me kërkesën fillestare përmes ankesës së datës 27.08.2021 si dhe plotësimin e saj me datë 01.08.2022, pasi që e tërë procedura që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri tek kompensimi sipas Vendimit të Këshillit A.nr.828/2018 i datës 02.04.2021 mbështet mbi të njëjtën situatë faktike.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se pala ankuese Vendimin A.nr.828/2018 të datës 02.04.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka pranuar me datë 15.04.2021 dhe ndaj të cilit në rast pakënaqësie sipas këshillës juridike ka mundur të parashtojë padi në gjykatën kompetente nëse e ka vlerësuar se vendimi i Këshillit nuk ka qenë i ligjshëm, mirëpo i njëjti vendim është pranuar si i mirëqenë dhe i ligjshëm nga palët në procedurë.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.775/2021

Flakron Gashi

*Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional*

Eshref SHABANI

*Kryetar i Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës,
- Arkivoit të KPMSHCK-së.

